



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E ZVEÇANIT OPŠTINA ZVEČAN ZVEČAN MUNICIPALITY	
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	CO
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	P-3-3/26
Nr. I faqeve Br. stranica No. pages	3
Data Datum Date	31. 03. 2026



Opština Zvečan
Komuna e Zveçanit
Municipality of Zvečan

Në bazë të neneve 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e RK-së" nr. 28/2008), nenit 9 dhe nenit 19 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Zveçanit, si dhe në bazë të nenit 63 të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, Kuvendi i Komunës së Zveçanit, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit paraprak dhe votimit, në mbledhjen e tij të 3-të (tretë) të rregullt në vitin 2026, të mbajtur më datë 31.03.2026, nxjerr:

V E N D I M

për përcaktimin e çmimores së tarifave për regjistrimin e mëvonshëm në regjistrin e gjendjes civile

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet çmimorja e tarifave monetare për regjistrimin e mëvonshëm të fakteve në regjistrin e gjendjes civile, të cilat kryhen në shërbimin e gjendjes civile të Komunës së Zveçanit, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.

Neni 2

Tarifat për regjistrimin e mëvonshëm në regjistrin e gjendjes civile përcaktohen në këto shuma:

1. **20 €** – për paraqitjen e mëvonshme të lindjes së fëmijës, kur lindja nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar me ligj;
2. **50 €** – për paraqitjen e mëvonshme të vdekjes, kur vdekja nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Neni 3

Tarifat nga neni 2 i këtij vendimi paguhet në buxhetin e Komunës së Zveçanit para zhvillimit të procedurës së regjistrimit të mëvonshëm në regjistrin e gjendjes civile.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjës kryetari i komunës dhe Drejtoria për Administratë dhe Personel – shërbimi i gjendjes civile i Komunës së Zveçanit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë nga dita e dorëzimit të organi mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve Komunale, si dhe 7 ditë nga shpallja publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të internetit të komunës.

Arsyetim

Ligji nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, veçanërisht neni 63, parasheh detyrimin për shqiptimin e tarifave monetare në rastet e regjistrimit të mëvonshëm të fakteve në regjistrin e gjendjes civile, kur paraqitja e lindjes ose e vdekjes nuk është bërë brenda afatit të përcaktuar me ligj. Me këtë ligj është përcaktuar detyrimi i institucioneve kompetente që të sigurojnë mbajtjen e rregullt të regjistrit të gjendjes civile dhe zbatimin e masave administrative të parapara.

Deri në nxjerrjen e këtij vendimi, Komuna e Zveçanit nuk ka pasur të përcaktuar çmimore të tarifave për regjistrimin e mëvonshëm në regjistrin e gjendjes civile, gjë që në praktikë ka sjellë zbatim jo të njëtrajtshëm të ligjit dhe vështirësi në veprimin e shërbimit të gjendjes civile në rastet e regjistrimit të mëvonshëm. Mungesa e një çmimoreje të rregulluar ka krijuar pasiguri juridike, si për qytetarët, ashtu edhe për personat zyrtarë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të gjendjes civile.

Përveç kësaj, në praktikë është konstatuar se ekziston një numër i konsiderueshëm i rasteve të paraqitjes së mëvonshme të fakteve të gjendjes civile, gjë që ka treguar nevojën që kjo procedurë të rregullohet në mënyrë të qartë dhe transparente, në përputhje me dispozitat ligjore.

Me nxjerrjen e këtij vendimi sigurohet:

- zbatimi i njëtrajtshëm i ligjit;
- siguria juridike për qytetarët;
- funksionimi më efikas i shërbimit të gjendjes civile;
- transparenca në punën e administratës komunale;
- harmonizimi me Ligjin për Gjendjen Civile.

Shumat e propozuara të tarifave janë përcaktuar në përputhje me kornizën ligjore, duke pasur parasysh parimin e proporcionalitetit, interesin publik dhe nevojën për të nxitur paraqitjen me kohë të fakteve të gjendjes civile.

Duke pasur parasysh se Kuvendi i Komunës së Zveçanit është kompetent për nxjerrjen e akteve të tilla të përgjithshme, si dhe se ekziston nevoja që puna e shërbimit të gjendjes civile të rregullohet në përputhje me ligjin, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
të Zveçanit



Dr Srdan Milosavljević